



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor

Nr. 7034/Prot., datë 23.12.2024



Universiteti Bujqësor i Tiranës

Nr. 3764/Prot., datë 23.12.2024

KONTRATË SHËRBIMI

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, godina nr. 4, Tiranë, i përfaqësuar nga Ministri **Z. Arbjan MAZNIKU** (këtu e më poshtë, për efekt të kësaj kontrate “Ministria”),

dhe

Universiteti Bujqësor i Tiranës, Institucioni më i rëndësishëm i formimit Universitar, Pasuniversitar, Kërkimit Shkencor, Trajnimit dhe Ekstensionit në fushën e Bujqësisë dhe Mjedisit, përfaqësuar nga **Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU** në cilësinë e Autoritetit më të lartë akademik të Universitetit Bujqësor të Tiranës, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare me adresë “Kodër-Kamëz, Tiranë (këtu e më poshtë për efekt të kësaj marrëveshje “UBT”).

Referuar në vijim si ‘Palët’, lidhin këtë kontratë mbështetur në marrëveshjen e bashkëpunimit me nr. ____ prot., me datë _____.2024, për rregullimin e marrëdhënieve në kuadër të institucionalizimit të bashkëpunimit në sferën e kërkimit shkencor.

Palët me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë nënshkruajnë këtë kontratë duke u mbështetur në parimet e së drejtës, lirisë kontraktore dhe rendit publik.

Neni 1

Objekti i kontratës

1. Objekti i kësaj kontrate përfshin:

- a) zhvillimin e projekteve në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe mbrojtjes së pyjeve;
- b) asistencë për bashkitë me profil zhvillimor bujqësor për identifikimin e faktorëve që sjellin prodhim optimal bujqësor në territorin e tyre dhe rritjen e mundësive për tregtim dhe eksportim të produkteve bujqësore vendore;
- c) hartimin e strategjive rurale vendore dhe të strategjive në sektorin e agro-turizmit për bashkitë me potencial zhvillimi;
- ç) zhvillimin e sesioneve informuese me bashkitë, trajnimeve ose konferencave të ndryshme me fokus bujqësinë, zhvillimin rural dhe mbrojtjen e pyjeve.
- d) asistencë për hartimin dhe funksionimin e mekanizmit pilot “Decentralizimi Horizontal”, për ushtrimin e funksioneve të përbashkëta në fushën e bujqësisë, me qëllim rritjen e rolit, pjesëmarrjes dhe përfshirjes së bashkive, sipas Urdhrit të Kryeministrit, nr.81, datë 15.5.2024.

Neni 2

Baza Ligjore

1. Në hartimin e kësaj kontrate bazohemi në kuadrin rregullator sa në vijim:

- a) Ligji nr.7850, datë 29.7.1994, “*Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- b) Ligji nr. 80/2015, “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar;
- c) Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar;
- ç) Vendimi nr. 188, datë 13.3.2019 të Këshillit të Ministrave, “*Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre*”, i ndryshuar;
- d) Vendimi nr.557, datë 4.10.2023 të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor*”;
- dh) Statuti i Universitetit Bujqësor të Tiranës; si dhe
- e) Marrëveshja e Bashkëpunimit me nr. __ prot. me datë __. __.2024 lidhur ndërmjet MSHPV-së dhe UBT-së.

Neni 3

Të Drejtat dhe Detyrimet e UBT-së

1. Me nënshkrimin e kësaj kontrate UBT-ja angazhohet të marrë përsipër përgjegjësitë sa në vijim:

- a) realizimin e kërkimeve shkencore dhe studimeve të nevojshme të fokusuar në evidentimin e mundësive dhe sfidave në zhvillimin e agro-turizmin në bashkitë me karakter bujqësor;
- b) realizimin e kërkimeve shkencore dhe studimeve të nevojshme në ato zona të cilat karakterizohen nga një potencial i lartë për tregtimin e produkteve bujqësore, duke i siguruar atyre akses në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare;
- c) krijimin dhe promovimin e marka-ve/brande-ve bujqësore për produktet bujqësore, duke përdorur metoda marketingu efikase për të realizuar një shpërndarje dhe njohje më të gjerë të tyre;
- ç) organizimin e trajnimeve, aktiviteteve dhe sesioneve me karakter informues dhe edukativ për fermerët, grupet e interesuara dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim përmirësimin e kapaciteteve për zhvillimin rural, duke ofruar mbështetje për krijimin e mundësive të reja për punësim dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në këto zona;
- d) monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë të vazhdueshme të projekteve, për të siguruar realizimin e objektit të parashikuar në nenin 1 të kësaj kontrate, si dhe arritjen e rezultateve të pritshme;
- dh) ofrimin e konsultimeve dhe mbështetjes për zhvillimin e strategjive të zhvillimit rural, duke ofruar ekspertizë për integrimin e teknologjive dhe metodologjive inovative;
- e) ofrimin e shërbimeve objekt të kësaj kontrate, në kohën e duhur dhe në mënyrë cilësore, sipas përcaktimeve kontraktore.

ë) asistencë për funksionimin e mekanizmit pilot “Decentralizimi Horizontal”.

2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate UBT-ja ushtron të drejta si më poshtë vijon:

- a) mund të kërkojë vënien në dispozicion të informacioneve, dokumentacionit dhe burimeve njerëzore nga MSHPV në funksion të realizimit të objektit të kësaj kontrate;
- b) mund të sigurojë bashkëpunim me aktorë të tjerë të sektorëve të ngjashëm, si organizata ndërkombëtare, institucione financiare, për të siguruar mbështetje financiare dhe teknike shtesë për realizimin e objektit të kësaj kontrate.

Neni 4

Të Drejtat dhe Detyrimet e MSHPV-së

1. Me nënshkrimin e kësaj kontrate MSHPV-ja angazhohet të marrë përsipër përgjegjësitë sa vijon:

- a) sigurimin e mbështetjes financiare për realizimin e projekteve, studimeve dhe çdo shërbimi tjetër që palët bien dakord të realizohet nga UBT-ja në kuadër të objektit të parashikuar në nenin 1 të kësaj kontrate, nëpërmjet fondeve buxhetore të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;
- b) sigurimin e asistencës dhe konsultimeve në hartimin e dokumenteve politike vendore në bashkitë me karakter bujqësor, në funksion të zhvillimit të agro-turizmit dhe tregtimit të produkteve bujqësore;
- c) promovimin e bashkëpunimit me aktorë të tjerë në nivel kombëtarë dhe ndërkombëtarë, për të siguruar një mbështetje më të gjerë dhe mundësi të tjera financimi.

2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate MSHPV-ja ushtron të drejta sa më poshtë vijon:

- a) kërkon realizimin e objektit sipas kësaj kontrate, në mënyrë cilësore dhe brenda afateve kohore të rëna dakord;
- b) monitoron dhe mbikëqyr realizimin e shërbimeve dhe të drejtave e detyrimeve kontraktore, duke kërkuar raporte të rregullta për ecurinë e zbatimit të tyre;
- c) kërkon nga Universiteti një raport financiar të dedikuar mbi çdo shpenzim të kryer;
- ç) kërkon rishikimin e studimeve dhe projekteve të realizuara për identifikimin e rezultateve dhe mundësive për përmirësime.

Neni 5

Vlefshmëria e kontratës

1. Kontrata lidhet për një afat kohor prej **1 viti** me të drejtë ripërtëritje. Ky afat fillon që nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 6

Ndryshimet dhe Zgjidhja e Kontratës

1. Palët mund të bëjnë ndryshime të dispozitave të kësaj kontrate me marrëveshje të përbashkët. Do të konsiderohen të vlefshme të tilla amendime, vetëm nëse janë në formë të shkruar dhe të nënshkruara nga të dyja Palët.
2. Kjo kontratë mund të përfundojë përpara afatit të përcaktuar në këtë kontratë, në rastet si më poshtë:
 - a) Palët mund t'a përfundojnë këtë kontratë në çdo kohë me marrëveshje ndërmjet tyre, përpara mbarimit të afatit të përcaktuar sipas nenit 7, duke njoftuar me shkrim 30 ditë para Palën tjetër;
 - b) Në rastet e ngjarjeve të forcës madhore, e cila zgjat për më shumë se 3 (tre) muaj dhe pasojat e të cilës nuk mund të rregullohen nga asnjëra Palë.

Neni 7

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga implementimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet Palëve.
2. Nëse mosmarrëveshjet nuk arrihen të zgjidhen me mirëkuptim, atëherë do të zgjidhen nga gjykata kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 8

Tarifa e Shërbimeve

1. Për shërbimet e ofruara në kuadër të kësaj kontrate, do të aplikohen tarifat e shërbimeve për të tretët të miratuara nga bordi i administrimit të Universitetit Bujqësor të Tiranës.
2. Shpenzimet për shërbimin e ofruar do të përballohen nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (*institucion në varësi të MSHPV-së*).
3. Universiteti, i paraqet një situacion ekonomik Agjencisë, për shpenzimet sipas aktiviteteve dhe shërbimeve në funksion të objektit të kontratës, që i bashkëlidhet kësaj kontrakte si **Aneksi nr.1**.
4. Vlera e pagesës e përlllogaritur sipas tarifave të shërbimit të miratuara nga bordi i

administrimit të Universitetit Bujqësor të Tiranës do të kryhet me dy faza. Pagesa e parë do të kryhet në masën 50% në momentin e nënshkrimit të kontratës së shërbimit dhe pagesa e dytë prej 50% do të kryhet pas marrjes në dorëzim të produkteve të kërkuara.

4. Në zbatim të pikës 1 të këtij neni, bashkëlidhet **Aneksi nr.2** që pasqyron tarifat e miratuara për shërbimet objekt kontrate.

Neni 9

Dispozita të Fundit

1. Palët shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë për nënshkrimin e kësaj kontrate.
2. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, palët angazhohen të ruajnë dhe të përpunojnë të dhënat personale në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.
3. Kjo kontratë hartohet në 4 kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 kopje për secilën palë.

Bashkëlidhur gjendet kopje e marrëveshjes së bashkëpunimit nr. __ Prot. me datë __. __.2024, ndërmjet Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës.

PËR

“MINISTRINË E SHTETIT PËR
PUSHTETIN VENDOR”

Z. Arbjan MAZNIKU



PËR

“UNIVERSITETIN BUJQËSOR
TË TIRANËS”

Prof. Dr Fatbardh SALLAKU

